



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 31.10.2016

**Vendim**  
**Nr. 59, datë 31.10.2016**

**PËR RIORGANIZIM TË PJESSHËM TË PLANEVE MËSIMORE NË  
PROGRAMET E STUDIMIT "BACHELOR NË INFERMIERI TË  
PËRGJITHSHME" DHE "INFERMIERI MAMI"**

Mbështetur në nenin 3, pika 2, shkronja **b** dhe nenin 38, shkronja **dh** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2016

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit Publik për riorganizimin e lëndës INF 160 *Principet bazë të infermierisë* nga lëndë semestrale në lëndë vjetore me dy module si më poshtë:  
Semestri i parë: 15 orë leksione (1 orë leksion në javë), 30 orë laborator (2 orë laborator në javë), 3 kredite;  
Semestri i dytë: 45 orë leksion (3 orë leksion në javë), 45 orë laborator (3 orë laborator në javë), 8 kredite.  
Kompensimi i krediteve për modulën INF 160 *Principet bazë të infermierisë* do të bëhet me lëndën INF 110 *Terminologji mjekësore* (semestri i parë), e cila nga 3 orë leksion në javë, 2 orë seminare, 7 kredite do të zhvillohet në 2 orë leksion në javë, 1 orë seminar, 4 kredite.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.